

2 Nisma për pëgjegjësinë e korporatave Rregulla detyruese për shkaktruesit

3 Diskriminim i shumëfishtë dhe strukturor Margjinalizimi në shumë rrafshe

4 Drama e refugjatëve në Moria Evakuim TANI-ne kemi vend!

Nr. 6 | tetor 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Nisma pezulluese e SVP/UDC refuzohet qartas nga popullata votuese

Ka ngadhënjyer Zvicra solidarare



Vania Alleva, kryetare e Unia dukshëm e lehtësuar pasi u bë i njohur rezultati. © Lucas Dubuis

Është një e diele e këndshme votuese për punëmarrësit, migrantët dhe familjet. Nisma pezulluese e SVP/UDC-së është refuzuar dukshëm, pushimi i atësisë është aprovuar dhe dhurimi tatimor për të pasurit dhe familjet e tyre është hedhur poshtë. Futja e pagës minimale prej 23 frangave në Gjenevë e bëri ditën votuese një super të diele! Tani është koha e duhur për një politikë progresive migracioni, për të gjithë!

Hilmi Gashi

Refuzimi i nismës pezulluese të SVP/UDC është e qartë. Gati 62% thanë qartas JO! Pikërisht 6 vite pas aprovimit të ngushtë të «nismës për imigrim masiv» SVP/UDC përjeton një humbje të dukshme në përpjekjen e saj për të përfunduar lëvizjen e lirë të personave dhe për të përkeqësuar pagat kushtet e punës dhe të drejtat e migrantëve.

Rezultati i këndshëm erdhi në shprehje edhe falë angazhimit të sindikatave, të cilat që nga fillimi bëri të dukshëm synimin perfid të SVP/UDC-së karshi punëmarrësve. Nisma pezulluese ishte një sulm në të drejtat e të gjithë punëmarrësve dhe të drejtave të tyre. Ajo donte të zëvendësonte lëvizjen e lirë të personave me kontingjentet diskriminuese dhe kështu të dobësonte të drejtat e të gjithë punëmarrësve në Zvicër. Pos kësaj iniciativë donte të hiqte masat mbrojtëse (FlaM), të cilat paraqesin shtyllën më të mirë mbrojtëse të pagave zvicerane. Rezultati i këndshëm votues përforcon Unia-n në qëndrimin e saj. Masat mbrojtëse dhe kështu edhe mbrojtja e pagave duhet të forcohet dhe jo të dobësohet. Unia kërkon më shumë kontrollë pagash dhe sanksione më të ashpra në rast dumpingu. Pos kësaj nevojiten pagat minimale kantonale dhe më shumë kontrata të përgjithshme të punës me vlefshmëri të përgjithshme. Edhe mbrojtja e punëmarrësve dhe aktivistëve sindika-

list, të cilët kundërshtojnë dumpingun në paga, duhet të fuqizohen. Një marrëveshje kornizë, e cila dobëson të drejtat e punëmarrësve dhe mbrojtjen e pagave Unia do ta luftojë me vendosmëri. Ne jemi të bindur, kjo marrëveshje do të dështojë sikurse nisma e SVP/UDC-së.

Solidaritet në vend të përjashtimit

Një kontribut qenësor për suksesin e fushatës kundërshtuese kanë dhënë edhe shoqatat e migrantëve. Ato me moton «Solidaritet në vend të përjashtimit» kanë treguar se sulmi i SVP/UDC atakon edhe të drejtat e migrantëve. Ato bënë të qartë se nuk vjen në shprehje kthimi e Zvicrës në kohën Aparteidit të statusit të sezonierëve, fëmijëve të fshehur dhe punëmarrësve pa të drejta. Edhe më shumë se kjo: Lëvizja e lirë e personave, si një e arritur nuk duhet vetëm të vazhdojë më tej, por edhe të zgjerohet, deri në një liri lëvizjeje për të gjithë.

Zvicra është një shoqëri migrante

Migrantet e migrantët kanë kontribuar atëherë sikur edhe sot përditë për suksesin shoqëror dhe imazhin e Zvicrës në botë. Kultura, sporti, ekonomia dhe shkenca përfitojnë nga realiteti i kësaj shumëllojshmërie. Përgjigja për sulmet e pandara në të drejtat tona të përbashkëta dhe në politikën



me dekada të tëra të fajtorit kujdestar quhet solidaritet. Këtu duhet të kemi të bëjmë edhe me zgjerimin e të drejtave të qëndrimit, sigurisë së qëndrimit, lirisë së qëndrimit të përhershëm, të drejtës për të jetuar bashkë me familjen dhe për të pasur të pak më shumë të drejtë dhe pjesën e vet në suksesin ekonomik e shoqëror të Zvicrës, pa përjashtim.

Paga minimale prej 23 frangave në Kantonin e Gjenevës

Një sukses sot e festojnë punëmarrësit edhe në Kantonin e Gjenevës. Iniciativa popullore e sindikatave për një pagë minimale prej 23 frangash në orë është aprovuar nga popullata votuese e Gjenevës. Kjo është një shenjë e qartë kundër pagave të ulëta të papranueshme.

Editorial



Fitore e solidaritetit

Rezultatet e votimeve të 27 shtatorit japin shkas për shpresë. Kjo si fillim është një Jo e qartë për nismën pezulluese të SVP/UDC-së. Votim ky i cili nga shumë anë është konsideruar si më i rëndësishmi i tërë legjislaturës.

Gjithsesi jo pa të drejtë. Pasi nisma pezulluese paraqiste një sulm të drejtpërdrejtë për të gjithë punëmarrësit dhe të drejtat e tyre. Nisma donte të zëvendësonte lëvizjen e lirë të njerëzve me kontingjentet diskriminuese. Aprovimi i saj do tu hiqte të drejtat kolegëve tanë pa shtetësi zvicerane. Kjo do të përcante punëmarrësit, do të ashpërsonte konkurrencën në tregun e punës dhe masat mbrojtëse (FlaM) dhe kështu do të shkatërronte njërin nga shtyllat kryesore të mbrojtjes së pagave. Andaj refuzimi i qartë është një fitore e punëmarrësve. Tani, me rastin e marrëveshjes kornizë me BE-në, mbrojtjen e pagave dhe kushteve të punës duhet trajtuar me rëndësinë më të madhe. Projekt-kontrata aktuale nuk është aspak e mjaftueshme për këtë. E kundërta: Ajo sakrifikon mbrojtjen e pagës zvicerane në altarin e tregut të lirë. Kjo nuk është e pranueshme. Masat mbrojtëse (FlaM) nuk janë plaçkë tregu. Ne do ta luftojmë vendosmërisht një marrëveshje kornizë, e cila dobëson të drejtat e punëmarrësve dhe mbrojtjen e pagave.

Rezultate tjera të qarta të votimeve kanë fuqizuar më tej Zvicrën sociale: refuzimi i dhurimit tatimor për të pasurit, futja e pushimit të lindjes për etërit; dhe jo së fundi edhe aprovimi i pagës minimale kantonale në Gjenevë prej 23 frangave në orë. Këto fitore të solidaritetit na japin energji të reja në këtë kohë të koronës. Ne ju falënderojmë përzemërsisht për angazhimin tuaj të madh.

Vania Alleva, kryetare e Unia

News

Gjyqi i Kantonit Waadt (Vaud) vërteton: Uber është një punëdhënës

Gjyqi i Kantonit Waadt (Vaud) ka marrë një vendim të Gjykatës së Punës të Lozanës dhe ka klasifikuar ndërmarrjen e taksive Uber si punëdhënës. Unia kërkon nga Uber, të gjithë shoferet/ët të pajisë me kontrata të rregullta pune dhe që atyre tu pagunë në mënyrë retroaktive pagat, kompensimin për harxhimet shtesë dhe kontributet për sigurimet shoqërore, të cilat u takojnë atyre. Kantonet duhet të kujdesen që Uber të respektoj ligjet. Nëse Uber edhe më tej nuk i respekton të drejtat e tyre, autoritetet duhet ta ndalojnë kompaninë që të ushtrojë këtë veprimtari, deri në kohën kur respektohet ligji dëshmuar.



Pamje nga një aksion kundër dumpingut në paga nga Uber

Përsëri valë reduktuese: Shkatërimi i GE duhet të ndalet

Prapë: General Electric (GE) paralajmëron shkarkimin e ardhshëm masiv. 562 vende pune të njësisë së GE në Grid në Oberentfelden duhet të fshihen. Ishte vala e katërt e reduktimit në këto katër vite. Përfaqësuesit e personelit dhe Unia kërkojnë hejën dorë complete të shkarkimeve. Unia kërkon nga qeveria federale që më në fund të fletë gjuhë të qartë me firmën. Është e papranueshme që GE të shkatërojë substancën e saj industriale në Zvicër. Qeveritë e vendeve duhet të investojnë në GE në SHBA e Francë, ku edhe merren vendimet. Nga Kantoni Aargau të prekurit presin që të ngjallë përsëri Task forcën, të cilën e pat angazhuar me rastin shkurtimeve të fundit tek GE. Politika duhet të ndërhyjë vendosmërisht, për të penguar shkatërimin e vendeve të punës në industri.

Sipërmarrësit kërkojnë shkurtime pagash për të gjithë!

Që nga fundi i gushtit 2020 janë duke u zhvilluar bisedimet për pagat mes sindikatave dhe shoqatës zvicerane të sipërmarrësve. Mirëpo, në vend se të shpërblehet me dinjitet puna e punëtorëve të ndërtimtarisë, sipërmarrësit kërkojnë shkurtime pagash për të gjithë! Afatshkurtër kriza e koronës ka frenuar aktivitetet ndërtuese, mirëpo në ndërkohë ekonomia e ndërtimit e ka marrë veten. Prognozat janë të mira. Në të njëjtën kohë jeta po shtrenjtohet. Sindikata kanë bërë të qartë pozicionin e tyre: punëtorët e ndërtimtarisë kanë merituar një rritje pagash. Një shkurtime pagash nuk vjen në shprehje!



Foto: Silvia Schönenberger / <http://sondersession.ch/rueckblick/>

Kushdo që shkakton dëme, duhet të mbajë përgjegjësi për to! Po iniciativës për përgjegjësinë e korporatave!

Pepo Hofstetter

Për biznese të përgjegjshme

Iniciativa, e cila mbështete edhe nga Unia, kërkon vetëkuptueshëm: kur korporatat si Glencore ndotin ujin e pijshëm, dëbojnë njerëzit nga pronat e tyre dhe nuk respektojnë të drejtat themelore të punëmarrësve, duhet të përgjigjen për dëmet e shkaktuara. Të prekurit duhet të kenë të drejtë që para gjyqit të kërkojnë nga përgjegjësit e qendrave të kompanive kompensim të dëmit. Ketë ankese ata duhet ta dëshmojnë që kompanitë kanë qenë përgjegjëse.

S'ka përparësi konkurrence përmes papërgjegjësisë

Shumë kompani punojnë me korrektësi. Mirëpo disa kompani të mëdha të paturpshme injorojnë të drejtat e njeriut dhe rregullat mjedisore, për të rritur profitin e tyre. Ata krijojnë përparësi konkurrence përmes papërgjegjshmërisë. Këtë donë ta ndryshojë iniciativa.

Trendi ndërkombëtar

Vende të ndryshme kanë krijuar rregulla ligjore, për të detyruar korporatat që tu përmbahen atyre. Edhe Komisionari i BE-së për Drejtësinë ka njoftuar gjithashtu rregullore detyruese për korporatat, pasi rregullat e deritashme janë treguar të pamjaftueshme.

Hap i vogël, por i rëndësishëm

Iniciativa është një hap i vogël, por i rëndësishëm për kushte korrekte punë në gjithë botën. Kushdo që bën biznes në të gjithë botën duhet të sillet me korrektësi - ndaj punonjësve, popullatës dhe mjedisit!



Glencore-njerëzit e sigurimit sulmojnë fermeret indigene para një miniere në Perù (dhjetor 2018). Foto: zVg

Rundi i pagave 2020/2021

100 franga më shumë për të gjithë punonjësit!

Ndikimet e krizës së koronës janë të ndryshme. Përderisa një pjesë e ndërmarrjeve, të pavarurit dhe një pjesë e të punësuarve janë të goditur rëndë, ekonomia në disa sektorë i ka punët mirë, deri edhe shumë mirë. Këto kanë përgjegjësi, të mbështesin mëkëmbjen ekonomike dhe fuqinë blerëse.

Për Unia është e qartë: Në shumë sektorë ka hapësirë veprimi për një rritje të përgjithshme pagash prej 100 frangave. Sektorët dhe ndërmarrjet, që janë ndarë mirë apo që gjatë krizës kanë zhvilluar biznes të mirë, duhet të marrin përgjegjësi. Punëmarrësit kanë kontribuar në masën më të madhe për këtë sukses. Kontributi i tyre duhet të njihet!

Nga duartrokitja nuk mund të jetohej

Qoftë në fushën e shëndetësisë, në shitje apo në logjistikë: Angazhimi i punonjësve në të ashtuquajturat sektorë esencial gjatë pandemisë ka qenë i tej theksuar. Unia llogarit me një rritje prej së paku 100 frangash si dhe për një premi prej së paku 200 frangash.

Barazi pagash tani!

Një rritje e përgjithshme e pagave në profesionet e shërbimit esencial paraqet një kontribut përkitazi me barazinë në paga.

Pasi në këto profesione punojnë kryesisht gratë – me paga të ulëta, të cilat as që mjaftojnë për një jetë me dinjitet.

Kërkesat e pagave për sektorët e Unia në detaje:

- Ndërtimtaria kryesore:** +100 franga për të gjithë; +100 për pagat minimale; pauzat e paguara paradite dhe pasdite.
- Bizneset (e artizanatit):** Për të gjithë sektorët +100 franga për pagat efektive; +100 franga për pagat minimale.
- Industria:** +100 franga për të gjithë.
- Tregtia me pakicë:** Pagë minimale prej 4000 frangash (x13); premi prej së paku një gjysmë page mujore për punonjësit në shitje, ushqim dhe tregtim online.

5. **Coop:** +100 franga, me përparësi për pagat e ulëta (pagë minimale prej së paku 4000 frangash x13) dhe për punonjësit me përvojë (pas 5 deri 10 vjetësh).

6. **Migros:** +100 franga për të gjithë; së paku 4000 franga (x13); Pagë minimale për punonjësit me përvojë; premi pres së paku një gjysmë page mujore për punonjësit në shitje, ushqim, tregtim online.

7. **Logjistikë:** +100 franga; premi për së paku 2000 frangave.

8. **Personeli i huazuar:** +150 franga për pagat minimale (pa kualifikim); rritje të pagës minimale në Tiçino në nivelin e pagës minimale kantonale.



Puna e grave në profesionet thelbësore kërkohet të përmirësohet dhe shpërblehet meritëshëm

Konferenca e Grave të Unia 2020

Kërkohen përmirësime në profesioneve thelbësore

Anita Frommenwiler

Kriza e koronës nuk guxon të bie në kurriz grave dhe migranteve, nevojitet më shumë njohje e konsideratë, para dhe kohë për rishpërndarje të kësaj pune relevante për sistemin.

Konferenca e Grave të Unia 2020 me 2 e 3 tetor tuboi 130 delegat nga të gjitha regjionet ku u kërkua forcimi i AHV/AVS, përfshirja e LGBTIQ+ dhe para së gjithash përmirësimi në profesionet thelbësore, të cilat për shkak të krizës së koronës ka zënë një vend polarizues në diskursin shoqëror. Faktikisht në profesionet thelbësore (fjala bie në përkujdes dhe shitje) punojnë në shumicë gratë, nga to kryesisht migrante. Edhe pse kjo pandemi tregon se sa relevante për sistemin është puna e tyre, pagat e tyre janë edhe më tej të ulëta, kushtet e punës dhe

siguria e qëndrimit shumë të këqija. Një pasiguri kjo që vazhdon të përkeqësohet. Përmes një dite aksioni me 31 tetor Gratë e Unia do të kërkojnë zëshëm, veçanërisht për sektorët e profesioneve thelbësore më shumë pagë, më shumë personel dhe më shumë kohë si dhe KKP (kontrata pune) me vlefshmëri dhe përfshirje të përgjithshme.

Kryesia e Grave të Unia pas 15 viteve drejtim të Ursula Mattmann-Alberto zëvendësohet nga Eleonora Failla. Unia me këtë rast falënderon Ursula Mattmann-

Alberto për angazhimin shumëvjeçar aktiv në sindikatë – dhe përshëndet sindikalisten e re feministë Eleonora Failla. Më tej që nga vera e vitit 2021 përqindja e grave shumicë do të merre përsipër drejtimin ekzekutiv në Unia. Krahas Vania Alleva, Véronique Polito dhe Renate Schoch rishitas është nominuar edhe Bruna Campanello (bashkë-drejtuese e sektorit të bizneseve artizanale). Një sinjal feministë i fuqishëm, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda, që tregon se strukturat patriarkale mund të tejkalohen bashkërisht.

Diskriminim i shumëfishtë i grave me sfond migracioni

Më të diskriminuara se sa gratë vendase, por edhe se sa burrat

Marie Saulnier Bloch

Migrantet konfrontohen me forma të ndryshme diskriminuese. Shpesh këto janë diskriminime të shumëfishta kumulative dhe të ndërthurura me njëra tjetrën. Kundër kësaj gjendjeje ne duhet me solidaritet të luftojmë.

Është e njohur, që gratë, para së gjithash ato të ashtuquajturave vendeve të treta, janë të prekura fortë nga e ashtuquajtura papunësi fërkuese. Kjo domethënë, ato duhet të ndërrojnë vendin e punës dhe ky ndërrim gjithmonë është i ndërlidhur me faza të papunësisë. Dhe papunësia strukturore, pasi që sipas rregullit rrugëtimi i tyre profesional për shkaqe familjare ndërpritet apo edhe hiqet tërësisht dorë nga profesioni. Krahasueshëm me këtë burrat janë më të prekur nga papunësia për shkaqe ekonomike. Kjo domethënë se ata humbin vendin e tyre të punës, pasi punojnë në profesione, të cilat i nënshtrohen luhatjeve ekonomike, fjala bie në bujqësi, në ndërtimtari apo në industri.

Migrantet në profesion i nënshtrohen diskriminimit në paga. Ato punojnë në sektorët me paga të ulëta me shumë

konkurrencë dhe janë të detyruara shpesh të marrin punë të shumta me paga tejet të ulëta, për të pasur mundësi të paguajnë faturat e tyre. Sigurimi i ekzistencës në këto kushte është një stres i përhershëm.

Kjo luftë e këtyre kolegeve është një luftë e të gjithë nesh

Diskriminimet e grave me sfond migracioni janë kumulative dhe të ndërthurura me njëra tjetrën. Ato janë si të natyrës juridike ashtu edhe të asaj ekonomike. Këtu bëjnë pjesë, për shembull, një status i pasigurtë qëndrimi, pabarazi në pagë, mungesë njohjeje të diplomave të huaja, etj. Mirëpo, diskriminimet mund të jenë të natyrës sociale e politike, pasi që gjoja ato mund të janë më pak produktive de sa burrat, edhe pse krahas pagës së keqe të punës, ato kryejnë edhe pjesën më të madhe të punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes për të afërmit.

Çështja e diskriminimit të shumëfishtë të migranteve nuk është vetëm çështje e ngurtësisë së tregut të punës. Kemi të bëjmë me modelin shoqëror, të cilin ne duhet ta luftojmë. Kërkesat për barazi sociale pra domethënë, të luftohen stereotipitë dhe të njihen e pranohet se kemi të bëjmë me barriera kulturore dhe esenciale sa i përket barazisë. Në migrantet jemi të marginalizuara në aspektin profesional, ekonomik dhe social. Ndër ne gratë jashtë BE-së dhe jashtë Evropës janë më të lëndueshmet dhe më së shumti të shfrytëzuara. Të jemi të vetëdijshëm për këtë, të mendohemi për këtë dhe të tregojmë solidaritet. Të mobilizohemi për të drejtat e të gjitha grave, pa përjashtim!

Interview



Lëvizja klimatike: për drejtësi klimatike dhe qëndrueshmëri

Bashkërisht për mbrojtje të klimës. Është urgjente!

Malet digjen. Shtrëngata, thatësira dhe përmbytjet shpeshtohen. Uji është duke mbaruar. Akullnajat zhduken... Nxejja klimatike është e dukshme për të gjithë. Megjithatë politika dhe ekonomia nuk bëjnë thujë se asgjë, për të zgjidhur këtë problem, më urgentin për njerëzimin. Lëvizja klimatike dhe shumë mbështetës luftojnë për mbrojtjen e klimës.

Horizonte bisedoi me sekretarin e Unia Roman Künzler, i cili është i angazhuar në lëvizjen klimatike.

Roman, a është situata e klimës aq urgjente si thotë lëvizja klimatike?

Situata është dramatike. Sistemi ynë i orientuar kah rritja e produktivitetit shkatërron planetin tonë. Ne jemi rrugës për një rritje të ngrohjes klimatike prej 4-6 gradësh. Nëse ne vazhdojmë kështu më tej, është afër mendësh se shumë pjesë të tokës nuk do të jenë me tej të banueshme. Për të mbetur nën 1.5 gradë ngrohje klimatike, ne nga viti 2030 nuk guxojmë të lirojmë më tej neto karburante e gazra serrash. Pra, është urgjente.

Rinia klimatike pushtoi sheshin federal, edhe pse ishte e ndaluar. A ishte kjo mosbindje civile joserioze?

Një aksion i mrekullueshëm dhe i suksesshëm! Aty qëndruan për 52 orë rresht me qindra njerëz, solidar, të vendosur, duke kënduar, për të ndryshuar diçka. Së fundi nën rrebeshin e shiut dhe të pagjumë. Këta njerëz shkruajnë historinë. Nganjëherë duhet të thyhen rregullat e të fortëve, për të krijuar parakushtet, që të ndryshohet diçka. Kjo ka qenë gjithmonë kështu. Kur ne të shohim pas 20 vitesh mbrapa në vitin 2020, ne do të pyesim veten, përse ne nuk kemi bërë më shumë, nuk kemi pushtuar më shumë sheshe.

Lëvizja klimatike kërkon «drejtësi klimatike». Çka domethënë kjo?

Drejtësia klimatike është një vizion i një shoqërie të drejtë sociale, e cila mundëson jetesën afatgjatë e të qëndrueshme në planetin tokë. Momentalisht barrën kryesore bartin ata, të cilët më së paku kanë kontribuar për krizën klimatike. Shtetet e pasura të OECD-së sikur Zvicra janë përgjegjëse për 75% të lirimit të misionëve të gazrave të serrave. Dhe edhe tek ne 10% e më të pasurve shkaktajnë 50% të lirimit të emisionëve. Prandaj, është e drejtë, që ata, të cilët kanë shkaktuar problemet, tani edhe të bartin koston e mëkëmbjes ekologjike e sociale të ekonomisë dhe shoqërisë.

A prek kriza klimatike edhe migrantet e migrantët?

Ajo prek të gjithë ne, mirëpo jo të gjithë njëjtë. Kështu njerëzit në vendet e varfra janë më shumë të prekur. Vendbanime të tëra qysh tani janë të pabanueshme, njerëz të detyruar të latë organizuar. Ku përndryshe, nëse jo në sindikata?

Çka mund të bëjë secili/a nga ne?

Ndryshimet politike janë procese kolektive. Ne duhet të bashkangjitemi grupeve dhe organizatave, apo të krijojmë tonat. Pastaj ne planifikojmë bashkë dhe veprojmë bashkë. Një është e qartë: vitet e ardhshme do të jenë të rëndësishme vendimtare.

Marilia Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shtesat familjare: A i marr ato, edhe nëse fëmija im fiton para gjatë zanatit?

Vajza jonë është 16 vjeçe dhe posa ka filluar me mësimin e zanatit. Djali ynë 22 vjeç është student. Një kolege imja thotë se shtesat familjare hiqen, posa një i ri fiton paratë e veta, dhe kjo edhe atëherë kur ai është duke ndjekur aftësimin profesional. A qëndron kjo?

DAVID AEBY: Jo. Shtesat e fëmijëve përfitojnë në shumën prej 200 frangave në muaj dhe paguhen, deri sa fëmija i mbush 16 vjet. Nga kjo 4kohë ekziston e drejta e përfitimit nga shtesat arsimore në shumë prej 250 frangave në muaj. Këto jepen deri në përfundim të arsimimit profesional, më së gjati deri në mbushjen e moshës 25 vjeç. Edhe nëse vajza juaj do të merre pagën e pare të shegertit dhe djali student gjithashtu gjatë pushimeve verore kryen ndonjë pune dhe fiton paratë e veta, ju megjithatë keni të drejtë në përfitim të shtesave arsimore. Kujdes: Ka një kufi fitimi. Nëse të ardhurat vjetore e të riut në arsimim është më e lartë se sa pensioni i plotë maksimal i AHV/AVS, kështu nuk ekziston e drejta e përfitimit të shtesave arsimore. Ky kufi i të ardhurave aktualisht është 28440 franga në vit ose 2370 franga në muaj.

(Work, 18 shtator 2020)

Mësimi i zanatit-murator: E drejta në gjashtë javë pushim vjetor?

Në fillim të gushtit kam filluar mësimin e zanatit të muratorit. Në ndërkohë ka filluar edhe shkolla profesionale. Një kolege shkollë më ka shpjeguar, se ajo ka gjashtë javë pushime vjetore. Sipas kontratës sime unë kam vetëm pesë javë pushim vjetor. Kolegja ime thotë. Se edhe unë duhet të kem gjatë javë pushime. A qëndron kjo?

PHILIP THOMAS: Po. Sipas të drejtës obliguese punëmarrësit kanë të drejtë në shtëpi të pushim vjetor. Për profesionin e muratorit nuk janë përcaktues vetëm rregullat e të drejtës obliguese. Vlen edhe kontrata kombëtare e punës për ndërtimtarinë kryesore (KKP). Kjo përmban edhe rregullat për mësimin e zanatit. Sipas KKP ata që janë duke u arsimuar kanë të drejtë në gjatë javë pushim vjetor. Kjo pra domethënë se kontrata jote e arsimimit profesional duhet të përshtatet me rregullat e KKP dhe se ju në fakt keni të drejtë në gjatë javë pushim vjetor.

(Work, 4 shtator 2020)

Puna sipas ftesës: A mund të kërkojë pagën time?

Që rreth një viti unë kryejë punë anësore në bazë të ftesës. Kjo ndërmarrje është e prekur edhe më tej fortë nga kriza e koronës. Në kohën e fundit unë nuk jam ftuar të punoj dhe kështu edhe nuk kam marrë pagë më tej. A kam megjithatë të drejtë të kërkojë pagën time?

PHILIP THOMAS: Siç ndodh shpesh, edhe kjo varet nga rrethanat konkrete. Tek puna sipas ftesës nuk ekziston e drejta e pagës më, nëse sikur shefit tuaj edhe ju u është lënë liria të vendosni a të punoni apo jo.

Nëse ju në të kundërtën për një kohë të gjatë keni pasur një përqindje punësimi konstant dhe juve nuk u është caktuar punë e mëtejme, atëherë keni të drejtë në pagë. Pasi ju duhet të keni besimin, se do të keni mundësi të punoni në masë të njëjtë.

Nëse firma juaj mund të vendos njëanshëm, kur ju duhet të punoni, keni të drejtë në pagën mesatare, kur firme papritur nuk ju thërret më për të punuar. Nëse vije deri tek shkarkimi, ju do të keni të drejtë në pagën mesatare deri në kalimin e afatit të shkarkimit. Në rast luhatjesh do të merren parasysh dymbëdhjetë muajt e fundit. Ndërmarrja ju detyron juve pagën edhe në rast të lirimit nga angazhimi në punë si dhe në rast se menjëherë nuk keni më ftesë për të kryer ndonjë punë.

(Work, 4 shtator 2020)

Enti Federal për Shëndetësi, 25.09.2020

Rekomandime të reja për fëmijët nën moshën 12 vjeç me simptoma

Gjetjet aktuale tregojnë: Fëmijët mund të infektohen me virusin e ri të koronës. Sidoqoftë, fëmijët nën moshën 12 vjeç kanë më pak simptoma dhe ka më pak të ngjarë të kalojnë virusin te njerëzit e tjerë.

Fëmijët nën moshën 12 vjeç duhet të mund të jenë në gjendje të ndjekin shkollën dhe entet e kujdesit. Fëmijët e kësaj grupmoshe kanë më pak të ngjarë të infektohen me virusin e ri korona në to, sesa në familje.

Rekomandimet tona

Fëmijë me simptoma të sëmundjes PA kontakt të ngushtë me një person me simptoma Covid-19

a) Fëmija juaj ka simptoma të buta të ftohjes (shkuarje hundësh, dhimbje fyti, kollë e lehtë). Përndryshe ai është mirë:

Fëmija juaj mund të vazhdojë të ndjekë shkollën ose institucionin e kujdesit.

b) Fëmija juaj ka ethe. Përndryshe ai është mirë:

Fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi. Atyre u lejohej të kthehen në shkollë ose në institucion vetëm pasi të mos kenë pasur ethe për 24 orë.

Nëse ethet zgjasin tre ditë ose më shumë, thirrni pediatrin.

Nëse fëmija juaj përjeton simptoma të tjera, të tilla si ankesa gastrointestinale, dhimbje koke, dhimbje trupi, humbje të nuhatjes dhe / ose shijes, atëherë diskutoni procedurën me pediatrin.

c) Fëmija juaj ka një kollë të fortë. Përndryshe ai është mirë:

Fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi. Ata mund të kthehen në shkollë ose në qendrën e kujdesit vetëm nëse kollat është përmirësuar ndjeshëm brenda tre ditësh.

Nëse ai qëndron i fortë për më shumë se tre ditë, telefononi pediatrin.

Nëse fëmija juaj përjeton simptoma të tjera, të tilla si ankesa gastrointestinale, dhimbje koke, dhimbje trupi, humbje të nuhatjes dhe / ose shijes, atëherë diskutoni procedurën me pediatrin.

d) Fëmija juaj ka një ethe ose kollë të rëndë dhe / ose nuk po shkon mirë:

Telefononi pediatrin për të diskutuar se si të procedoni.

Fëmijë me simptoma të sëmundjes ME kontakt të ngushtë me një person me simptoma Covid-19

Personi me të cilin fëmija juaj ka qenë në kontakt të ngushtë është testuar.

a) Rezultati i provës së personit është POZITIV:

Fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi. Duhet të jetë në gjendje të testohet. Thirrni pediatrin. Më pas do të merrni informacione se si të procedoni.

b) Rezultati i provës së personit është NEGATIV:

Fëmija juaj lejohej të shkojë përsëri në shkollë ose në një institucion përkujdesjeje pasi nuk ka pasur më ethe për 24 orë ose kollat është përmirësuar ndjeshëm.

Fëmijët me simptoma të sëmundjes në një klasë shkolle ose në një grup kujdesi

Nëse tre ose më shumë fëmijë janë të sëmurë në një klasë shkolle ose në një grup kujdesi, autoritetet kantonale, në konsultim me pediatrit përgjegjës, përcaktojnë se si duhet të veprojnë fëmijët.

Drama e refugjatëve në Moria

Evakuim TANI – ne kemi vend!

Në natën e 9 shtatorit në kampin më të madh evropian të refugjatëve në ishullin Mori të Greqisë shpërthyen shumë vatra falkësh. Kampi edhe ashtu i stërbushur me më shumë se 12000 njerëz, shkaku i pandemisë së koronës ishte i ndarë nga bota e jashtme, dhe thajse u dogj tërësisht.

Marek Wieruszewski

Shkaku i zjarreve të 12000 azilkërkuesve, nga të cilët 2200 gra dhe 4000 fëmijë u është dashur të flenë jashtë, në qiellin e hapur, nëpër rrugë, ara dhe plazhe. Midis tyre ka njerëz veçanërisht të pambrojtur, fëmijë të vegjël, gra shtatzëna, të mos-huar dhe gjithashtu njerëz me aftësi të kufizuara.



Marrëveshja – Turqi

Greqia ka provuar, që shkaku i marrëveshjes së BE-së me Turqinë, refugjatët të mbajë në ishujt leros, Chios, Kos, Samos dhe Lesbos. Azilkërkuesit duhet të qëndrojnë në kampet e refugjatëve në ishull, nën kushte tejet të këqija dhe të presin vendimet mbi azil dhe në rast të refuzimit të mund të dërgohen prapa në Turqi. Pasi që Turqia, shkaku i pandemisë së koronës nuk pranon hyrje të personave, kjo gjendje edhe ashtu e rëndë bëhet edhe më dramatike.

Ne kemi vend

Evropa nuk guxon të lejojë një gjendje të tillë. Njerëzit, të cilëve u duhet të lëshojnë atdheun e tyre shkaku i përndjekjes, luftës dhe urisë, nuk meritojnë të sistemojnë nën kushte të tilla të padinjitetshme. Andaj organizata të shumta, të mbështetur nga përfaqësuesit e kulturës, sportit dhe politikës, kërkojnë që shumë refugjatë nga ky regjion të bihen në Zvicër. Më shumë informata gjenden në faqen e internetit: <https://evakuieren-jetzt.ch/>



S'ka pagë? Shkaku i pak angazhimeve në punë?

Tregoni punëdhënësit tuaj, se cilat janë të drejtat tuaja! Në rast se keni pak angazhime, gjegjësisht nëse nuk merrni më tej pagë, Unia në uebfaqen e saj ka përgatitur disa mostra letrash në Word në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht, të cilat i ka vu në dispozicion, dhe të cilat ju mund të shkarkoni dhe përshtatni. Këto i gjeni në: www.unia.ch/de/arbeitwelt/von-a-z/coronavirus/kein-lohn-keine-einsaetze